



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 2134/1 Prot.

Vlorë më, 30.09.2024

VENDIM

Nr. 11, datë 30.09.2024

PËR

NDARJEN E NGARKESËS MËSIMORE VJETORE TË PEDAGOGËVE PËR
ÇDO VIT AKADEMIK

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë", të MAS, dhe në zbatim të Udhëzimit nr 37 datë 04.12.2018 "Për një ndryshim të Udhëzimit Nr 29 datë 10.09.2018" të MAS, Rektorati i UV në mbledhjen e datës 30.09.2024

VENDOSI:


Drejtuesit e Njësive Bazë në shpërndarjen e ngarkesës mësimore vjetore të pagueshme në çdo vit akademik, për çdo pedagog të zbatojnë detyrimet ligjore të sipërcituara:

1. Mbingarkesa mësimore vjetore e pagueshme brenda dhe jashtë auditorit për secilin pedagog nuk do të kalojë mbi 300 orë mësimore në veprimtaritë akademike mësimore: leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika.
2. Orët e udhëheqjeve të temave të diplomës (bachelor dhe master), si dhe doktoraturave të llogariten mbi këtë mbingarkesë, si pjesë e veprimtarisë kërkimore-shkencore.
3. Maksimumi i lëndëve/moduleve të lejueshme për simestër është 3(tre).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Aurela SALIAJ



Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
www.univlora.edu.al
++355222288

Web-site:
Tel. Fax
e-mail: info@univlora.edu.al